

Materiali i meposhtem eshte pjese e Departamentit te Administrates Publike marre nga “Plani i Qeverise Shqiptare per Perafrimin e Legjislacionit dhe Zbatimin e Marreveshjes se Stabilizim Asociimit” miratuar me VKM nr. 314 date 13.05.2005

1.1 Funksionimi i administrates publike

1.1.1.1 Departamenti i Administrates Publike

Objektivat

Angazhimet ne kuadrin e MSA-se

Neni 110

- krijimi i një administratë transparente, të hapur, të përgjegjshme dhe koherente.
- forcimi institucional; sigurimi i procedurave të paanshme të rekrutimit; manaxhimi i burimeve njerëzore; zhvillimi i karrierës; trajnimet; promovimi i etikës në administratën publike; zhvillimi i teknologjive te informacionit ne fushen e *e-government*.
- masat qe duhet te merren per funksionimin sa me efikas te institucioneve shtetore duhet te perfshijne si administraten e organeve qendrore ashtu edhe ate te organeve vendore.

Angazhimet qe rrjedhin nga Partneriteti European dhe Raporti i Stabilizim-Asociimit, ne pjesen “Vlerësimi i institucioneve demokratike dhe qëndrimit ndaj shtetit”:

- permiresimi i legjislacionit te sherbimit civil dhe zbatueshmeria e tij;
- forcimi i rolit te Sekretarit te Pergjithshem ;
- permiresimi i sistemit te menaxhimit te burimeve njerezore ne institucionet e administrates qendrore te perfshira ne sherbimin civil per te siguruar procedura rekrutimi transparente dhe te paanshme dhe zhvillimin e karrieres se nepunesve civile;
- rritja e kapaciteteve te nepunesve civile nepermjet trajnimit te tyre;
- forcimi i institucioneve te administrates publike, sigurimi i strukturave efektive per realizimin e misionit te tyre, motivimi i nepunesve civile;
- zhvillimi i teknologjive te informacionit ne fushen e e-government;
- promovimi i etikes ne administraten publike.

Situata e tanishme

Institucionet dhe politikat

Ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi dhe politikat e qeverise ne fushen e administrates publike, Departamenti i Administrates Publike ka si fokus te punes se tij:

- Menaxhimin e përgjithshëm të shërbimit civil, të institucioneve të administratës qendrore, veprimtaria e të cilave rregullohet nga legjislacioni i shërbimit civil (rekrutimi, karriera, përshkrimi i punës, vlerësimi i punës, masa disiplinore, trajnimi);
- Rishikimin funksional dhe strukturor të institucioneve të administratës publike;
- Reformën në fushën e pagave për institucionet e administratës publike;
- Masivizimin e teknologjive të informacionit në fushën e qeverisjes elektronike (e-government);

Në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nepunësimit civil”, **Departamenti i Administratës Publike** ka si kompetencë të përgjithshme: zhvillimin, zbatimin dhe mbikeqyrjen e politikave qeveritare në shërbimin civil dhe çështje të tjera në lidhje me personelin; përgatitjen e një raporti vjetor mbi situatën e përgjithshme të shërbimit civil të cilin ia paraqet Këshillit të Ministrave; ushtrimin e çdo kompetence mbi çështje të personelit, që nuk i janë dhënë shprehimisht me ligj institucioneve të administratës qendrore.

Ndërsa në kuadër të përgjegjësisë së vecanta, DAP fokusohet në: përgatitjen për Këshillin e Ministrave të akteve nenligjore; dënimin e mendimeve për ligjshmerinë e projektakëve nenligjore, të propozuara nga ministratë, përgatitjen për Këshillin e Ministrave të klasifikimit dhe vlerësimit të vendeve të punës dhe ndryshimet në to; përgatitjen dhe publikimin e udhëzimeve të përgjithshme, procedurave, manualeve dhe formularëve për përshkrimin, klasifikimin, dhe vlerësimin e pozicioneve të punës për nepunësit civilë si dhe për rekrutimin, seleksionimin, ngritjen në detyrë, levizjen paralele, masat disiplinore dhe vlerësimin e rezultateve në punë; hartimin dhe zbatimin e programeve me qëllim rritjen e efikasitetit në shërbimin civil; hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të përgjithshme të trainimit të zbatueshëm për shërbimin civil në tërësi; mbikeqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore; përgatitjen për Këshillin e Ministrave, me propozim të institucioneve të administratës qendrore dhe me miratim të Ministrisë së Financave, planet afatmesme dhe afatgjata për personelin, përgatitjen për miratim në Ministrinë e Financave, të strukturës së pagave për punonjësit e administratës publike qendrore dhe vendore.

DAP mban dhe administron Regjistrin Qendror të Personelit.

Departamenti i Administratës Publike ka një strukturë të miratuar prej 18 nepunësish të ndara në tre sektore:

- (Drejtori\Arshivistja);
- Sektori i menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, (6 nepunës);
- Sektori i zhvillimit organizativ, funksional dhe pagave, (6 nepunës);
- Sektori i informatizimit të administratës dhe koordinimit të projekteve. (4 nepunës).

Komisioni i Shërbimit Civil është institucion i krijuar në bazë të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nepunësimit civil” dhe ka për detyrë zgjidhjen e ankesave ndaj

vendimeve lidhur me pranimin ne sherbimin civil, periudhen e proves, ngritjen ne detyre, levizjen paralele, vleresimin, masat disiplinore e te drejtat e nepunesit civil, dhe mbikeqyr zbatimin e ligjshmerise ne menaxhimin e burimeve njerezore ne te gjitha institucionet qe hyjne ne fushen e veprimit te ligjit te permendur me siper.

Per pergatitjen dhe dhenien e trajnimeve per nepunesit e administrates publike eshte ngritur **Instituti i Trajnimit te Administrates Publike**. ITAP varet nga Keshilli i Ministrave dhe drejtohet nga Departamenti i Administrates Publike per sa i perket percaktimit te objektivave dhe planeve te punes. ITAP vepron si nje strukture menaxhuese e trajnimeve. Pas vleresimit te nevojave per trajnim dhe hartimit te programeve te punes, ITAP kontraktton eksperte te jashtem per hartimin e kurrikulave te trajnimit dhe dhenien e trajnimeve. Gjithashtu organizohen edhe trajnime te trajnereve, me qellim rritjen e numrit te eksperteve te afte per dhenien e trajnimeve dhe zgjerimin e bazes se zgjedhjes se tyre nga ITAP.

Trajnimet

Qe ne fazat e para te krijimit te tij, nepunesit e Departamentit te Administrates Publike jane trajnuar ne ceshtje te ndryshme te lidhura me menaxhimin e burimeve njerezore, sipas fushes se aktivitetit qe mbulojne ne Departament. Nepunesit i jane nenshtuar trajnimeve te organizuar nga Instituti i Administrates Publike me teme:

- Prezantim ne Administraten Publike
- Menaxhimi efektiv

Bashkepunimi

Ne realizimin e objektivave te tij, Departamenti i Administrates Publike bashkepunon me :

1. **Ministrите e linjes**, lidhur me menaxhimin e burimeve njerezore.
2. **Ministrите e linjes** dhe te gjitha **institucionet e tjera** te administrates publike per realizimin e objektivave ne fushen e reformes se pagave dhe forcimit institucional. Ky bashkepunim realizohet nepermjet:
 - rishikimit te akteve ligjore dhe nenligjore te pergatitura;
 - hartimit te udhezimeve dhe procedurave;
 - reformes se pagave dhe forcimit institucional.
3. **Komisionin e Sherbimit Civil**, me ane te nje marreveshje mirekuptimi te lidhur mes ketyre institucioneve, e cila lehteson shkembimin e informacionit dhe asistencen reciproke ne realizimin e misioneve te secilit institucion.
4. **Institutin e Trajnimit te Administrates Publike** per sa i perket percaktimit te objektivave dhe planeve te punes.

Bashkepunimi me institucionet nderkombetare

Departamenti i Administrates Publike bashkepunon me institucione nderkombetare ne te gjitha fushat e veprimtarise se tij, bashkepunim i cili konkretizohet ne shkembimin e

informacionit dhe marrjen e konsulences nga institucione nderkombetare te specializuara per projektet me te rendesishme te hartuara nga Departamenti. Nje bashkepunim i veçante eshte ai me SIGMA ne fushen e hartimit te legjislacionit dhe reformen e pagave.

Vleresimi

Eksperienca kater vjeçare e implementimit te legjislacionit te nepunesit civil, eshte analizuar ne menyre te veçante ne fund te çdo viti kalendarik, ne ate qe quhet **Raporti i Departamentit te Administrates Publike per reformen ne sherbimin civil**. Keto raporte analizojne ne detaje çeshtjet e zbatimit te legjislacionit te sherbimit civil, veshtiresite ligjore, strukturore, organizative dhe funksionale qe dalin gjate zbatimit, si dhe sherbejne per realizimin e propozimeve dhe ndryshimeve ne aktet ligjore per permiresimin e procedurave ligjore, por edhe te praktikave institucionale, njekoheesisht me zbatimin e ligjit. Departamenti i Administrates Publike realizon mbikqyrjen e zbatimit te legjislacionit nepermjet indikatorëve te suksesit, te cilet botohen dhe publikohen çdo tremujor dhe jane instrumente monitorimi dhe reflektimi per arritjet ne zbatimin e legjislacionit te nepunesit civil.

Kuadri ligjor

Legjislacioni per sherbimin civil

- Ligji nr. 8549 date 11.11.1999 “Statusi i nepunesit civil”, i cili rregullon shtrirjen e sherbimit civil ne administraten publike shqiptare, percakton parimet e pergjithshme, institutet dhe institucionet per menaxhimin e sherbimit civil.
- VKM nr. 231 date 11.05.2000 “Per pranimin ne sherbimin civil dhe periudhen e proves”, i ndryshuar, ku percaktohen procedurat lidhur me organizimin e procesit te rekrutimit ne sherbimin civil dhe konfirmimin e nepunesve ne perfundim te periudhes se proves.
- VKM nr. 306 date 13.06.2000 “Per disiplinën ne sherbimin civil”, i cili detajon rastet qe çojne ne marrjen e masave disiplinore dhe proceduren qe duhet ndjekur ne keto raste.
- VKM nr. 342 date 14.07.2000 “Per levizjen paralele dhe ngritjen ne detyre te nepunesit civil”.
- VKM nr. 360 date 14.07.2000 “Per lirimin nga sherbimi civil”, i cili detajon kriteret dhe procedurat per lirimin nga sherbimi civil te nepunesve civile si dhe procedurat e ndjekura ne rastet e ristrukturimit te institucioneve.
- VKM nr. 315 date 23.06.2000 “Per krijimin dhe funksionimin e Institutit te Trajnimit te Administrates Publike dhe trajnimin e nepunesit civil”, i ndryshuar, i cili rregullon statusin institucional dhe detyrat e ITAP ne procesin e trajnimit te nepunesve civile.
- VKM nr. 325 date 21.05.2003 “Per pozicionin, detyrat dhe pergjegjesite e Sekretarit te Pergjithshem ne ministri”. Nepermjet ketij vendimi jane percaktuar detyrat e sekretarit te pergjithshem ne ministri dhe roli i tij ne institucion, si ura lidhese mes nivelit politik dhe atij te sherbimit civil.
- Udhëzimi nr. 1 date 13.06.2000 i Keshillit te Ministrave “Per strukturen e renditjes se puneve ne sherbimin civil, metodologjine perkatese dhe pershkrimin

pergjithesues te rolit te sekretarit te pergjithshem ne kete sherbim”. Nepermjet ketij udhezimi jane parashikuar metodologjia dhe procedura per hartimin e pershkrimet te punes per te gjitha pozicionet si dhe menyra e vleresimit te rendesise se tyre.

- Udhezimi nr. 2 date 07.07.2000 i Keshillit te Ministrave “Per sistemin e vleresimit te arritjeve vjetore individuale te nepunesve civile”, i cili percakton metodologjine dhe proceduren per vleresimin e arritjeve individuale te nepunesve. Me kete udhezim eshte miratuar edhe formulari i vleresimit te punes.

Legjislacioni per etiken

- Ligji nr. 9131 date 08.09.2003 per “Rregullat e Etikes ne Administraten Publike”, i cili percakton standartet etike te cilat duhet te respektohen nga nepunesit publike dhe menyren e sigurimit te zbatimit te ketyre standarteve.
- VKM nr. 714 date 22.10.2004 “Per veprimtarite e jashtme dhe dhenien e dhuratave gjate veprimtarise se nepunesit te administrates publike”;

Legjislacioni per pagat

- Ligji nr. 9065 date 08.05.2003 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr 8487, date 13.05.1999 “Per kompetencat per caktimin e pagave te punes”, i ndryshuar. Ky ligj percakton kompetencat e institucioneve per percaktimin e pages dhe ngarkon Departamentin e Administrates Publike per hartimin e akteve ne kete fushe.
- VKM nr. 711 date 27.12.2001, i ndryshuar, i cili percakton nivelet e pages per nepunesit civile te institucioneve te administrates qendrore.

Legjislacion tjetër i rendesishem

- Ligji nr. 9000 date 30.01.2003 “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave”, i cili percakton menyren e organizimit te institucioneve ne sferen e ekzekutivit dhe kompetencat per krijimin e ketyre institucioneve.
- VKM nr. 173 date 07.03.2003 “Per emerimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra te drejtuesve te institucioneve ne varesi te Keshillit te Ministrave, Kryeministrit, ose te ministrit”. Ky vendim percakton kriteret qe duhen ndjekur dhe proceduren qe duhet zbatuar ne rastet e emerimit te titullareve te ketyre institucioneve, duke e perafuar proceduren me ate te parashikuar ne legjislacionin per sherbimin civil.
- Kodi i Procedurave Administrative, i miratuar me ligjin nr. 8485 date 12.05.1999, i cili synon te rregulloje veprimtarine e institucioneve te administrates publike ne perputhje me parimet e se drejtes administrative, shmangien e konfliktit te interesave ne rastet e vendim marrjes, proceduren e aktit administrativ si dhe proceduren per ankimimin administrativ.
- Ligji nr. 8503 date 30.06.1999 “Per te drejten e informimit per dokumentat zyrtare”. Qellimi kryesor i ketij ligji eshte qe te percaktoje parimet e nje administrate te hapur dhe transparente ne veprimtarine e saj ne marredheniet me publikun. Sipas ketij ligji te gjithe personat e interesuar mund te njihen me dokumentat zyrtare, perveç rasteve kur keto jane konfidenciale.
- Keshilli i Ministrave ka miratuar me Vendimin nr.98, date 18.02.2005, projektligjin per “Konfliktin e interesave” i cil eshte tashme per diskutim ne

Parlament. Projektligji i miratuar synon sigurimin e kuadrit ligjor per nje vendimarrje te paaneshme, transparente dhe te pergjegjeshme ndaj publikut, nga njera ane dhe forcimi i besimit te publikut ndaj institucioneve publike, nga ana tjeter. Projektligji permban nje perkufizim te qarte te konfliktit te interesave ne dinamizmin e tij sipas cdo fushe te vendimarrjes nen formen e konfliktit aktual, aparent, potencial dhe rast pas rasti. Projektligji parashikon gjithashtu ndalime dhe limitime te interesave private te punonjesit publik si dhe mjetet alternative per shmangien e situatave te konfliktit te interesit. Projektligji parashikon pasojat dhe efektet mbi aktet e marra ne situatat e konfliktit te interesit, sanksionet disiplinore dhe administrative dhe strukturat pergjegjese per implementimin e ligjit.

Ndihma e huaj

Qe ne krijimin e tij Departamenti i Administrates Publike eshte asistuar ne nivel teknik me qellim realizimin e objektivave te percaktuara ne ligj:

1. Ne kuadrin e programit PHARE Departamenti i Administrates Publike eshte asistuar nepermjet programit AL9705 "Public administration reform" per:
 - asistence teknike ne hartimin e legjislacionit dytesor;
 - asistence teknike ne krijimin e bazes se te dhenave per nepunesit e administrates publike;
 - asistence teknike per sistemet e menaxhimit te dokumentacionit;
 - trajnimi i nepunesve civile shqiptare;
 - trajnimi i drejtuesve te burimeve njerezore ne sistemet e menaxhimit te dokumentacionit;
 - program trajnimi per Departamentin e Administrates Publike;
 - paisje IT dhe zyre per Departamentin.
2. Programi i Bankes Boterore "Asistence ne implementimin e legjislacionit per sherbimin civil", i fokusuar ne keto komponente:
 - zhvillimi i procedurave te zbatimit te legjislacionit per sherbimin civil;
 - mbeshtetja e agjencive publike per implementimin e legjislacionit per sherbimin civil;
 - publikimi i ligjit "Statusi i nepunesit civil" dhe strategjia e implementimit te tij;
 - monitorimi dhe vleresimi i legjislacionit per sherbimin civil.

Departamenti i Administrates Publike vazhdon te mbeshtetet nga partneret nderkombetare nepermjet disa projektesh ne zhvillim e siper:

3. Programi Cards 2003, me dy nenkomponente:
 - a. Inkurajimi i reformes ne sherbimin civil:
 - forcimi i kapaciteteve te Departamentit te Administrates Publike ne implementimin e reformes;
 - permiresimi i implementimit te ligjit nepermjet nje fushate komunikimi;
 - mbeshtetja e luftes ndaj korrupsionit dhe percaktimi i standarteve etike;

- rritja e kapaciteteve te ITAP per livrimin e trajnimeve.

b. Krijimi i rrjetit nderqeveritar te transmetimit te te dhenave dhe informacionit.^[1]

Ky projekt ka filluar te zbatohet per te dy nenkomponentet.

4. Projekt i Bankes Boterore per rishikimin organizativo-funksional te institucioneve te administrates publike. Ne kete projekt eshte perzgjedhur shoqeria konsulente dhe aktualisht jemi ne fazen e nenshkrimin te kontrates.
5. Ne kuadrin e programit Cards 2004, jane miratuar disa projekte te cilat do te financohen nga BE me vlere 2 milion Euro si:
 - rikonstuksioni dhe paisja e ndertesese se re te Institutit te Trajnimit te Administrates Publike;
 - asistence teknike per zhvillimin e sistemit te trajnimit te nepunesve publike;
 - paisje IT per rrjetin qeveritar.

Perparsite afatshkurtra 2005-2006

Masat legjislative

Qeveria e Republikes se Shqiperise ka ndermarre iniciativen e rishikimit te legjislacionit per sherbimin civil mbeshtetur ne: strategjine e Qeverise se Republikes se Shqiperise per reformen institucionale dhe administraten publike; analizat e bera nga Departamenti i Administrates Publike; rekomandimet e Bashkimit European te shprehura ne Raportin vjetor te vitit 2004; dhe objektivat e percaktuara ne Marreveshjen e Stabilizim Asociimit. Eshte pergatitur projektligji per ndryshimin e ligjit "Statusi i nepunesit civil", duke synuar:

- zgjerimin e fushes se veprimit te legjislacionit per sherbimin civil dhe shtrirjen ne te gjitha institucionet e sferes se ekzekutivit dhe te pushtetit vendor;
- permiresimin e sistemit te rekrutimit te burimeve njerezore duke rritur transparencen, profesionalizmin dhe cilesine e konkurimeve, rritjen e cilesise se konkurrenteve te rekrutuar, uljen e ndikimeve ne perzgjedhjen e fituesve, permiresimin e sistemit te karrieres te nepunesve civile, uljen e kostove te procedurave te rekrutimit.

Ligji eshte parashikuar te miratohet ne Kuvend brenda 3-mujorit te trete 2005.

1. Ndryshimi i ligjit "Statusi i nepunesit civil" e ben te domosdoshme nje nderhyrje ne legjislacionin dytesor te dale ne zbatim te ketij ligji. Kjo per vete filozofine e ligjit, sipas te ciles ne ligj parashikohen vetem parimet dhe procedurat kryesore, te cilat detajohen me pas me akte nenligjore. Parashikohet qe keto nderhyrje ne aktet nenligjore te perfundojne brenda tremujorit te katert te vitit 2005, ne varesi te miratimit te projektligjit nga Kuvendi.

^[1] I bashkefinancuar nga UNDP

2. Ne kuadrin e masave te parashikuara ne planin e veprimit per Partneritetin Europian, eshte parashikuar rritja e perdorimit te teknologjive te informacionit ne institucionet e administrates publike, duke synuar forcimin e mireqeverisjes.

Nen kete objektiv eshte parashikuar krijimi dhe venia ne funksionim e Regjistrat Kombetar te Administrates Publike (data base i nepunesve publike). Meqenese soft-i kompjuterik parashikohet te jete *web based*, per te lehtesuar hedhjen e te dhenave nga pika te jashtme te sistemit, del e nevojshme percaktimi i disa rregullave per hedhjen e te dhenave, kontrollin dhe perdorimin e tyre, te cilat do te miratohen nga Keshilli i Ministrave.

Masat zbatuese

1. Ndryshimi ne ligj nuk do te sjelle si pasoje krijimin e institucioneve te reja, por ato ekzistuese duhet te pershtaten me nevojat e dala nga ligji i ri, sipas drejtimeve te meposhteme:
 - Shtimi i numrit te personelit te Departamentit te Administrates Publike, i cili mbikqyr procesin e rekrutimit te nepunesve civile Keshtu, per shkak te zgjerimit te fushes se veprimit te ligjit me institucionet e varesise (proces i cili do te zhvillohet ne disa faza ne varesi te dy kriterëve: 1. perfundimit te rishikimit funksionalo – strukturor te institucioneve, dhe 2. rritja e kapaciteteve per implementimin e ligjit). Nga vleresimet e bera rezulton te jene te nevojshem tre nepunes shtese ne Sektorin e Menaxhimit dhe Zhvillimit te Burimeve Njerezore te cilet duhet te rekrutohen pas miratimit te ligjit ne Kuvend.
 - Shtimi me dy specialiste i Sektorit te Zhvillimit Organizativ, Funksional dhe Pagave, per te perballuar shtesen ne volumin e punes lidhur me vleresimin e pozicioneve te punes, pershkrimin e pozicioneve te punes dhe reformen funksional strukturore.
 - Nderhyrje do te kryhen edhe ne institucionet te cilat do te perfshihen ne fushen e veprimit te ligjit, ku do te riorganizohen njesite e menaxhimit te burimeve njerezore, sipas standarteve te aplikuara aktualisht ne ministrite e linjes.
 - Njekohesisht eshte parashikuar te trajnohet stafi i njesive te menaxhimit te burimeve njerezore ne te gjitha institucionet ne fushen e veprimit te ligjit, per tu njohur me ndryshimet ne ligj dhe institutet e reja/te ndryshuara te parashikuara.
2. Hartimi i udhezimeve per veprimtarine e komiteteve te testimi: Ndryshimi i ligjit do te sjelle si pasoje rishikimin e menyres se zhvillimit te rekrutimeve, per sa i perket anes menaxheriale te zhvillimit te tyre. Per te siguruar zbatimin e standarteve te njejta dhe sa me te larta ne te gjitha konkurimet, si edhe per te transpozuar ne praktike dispozitat ligjore, do te hartohen udhezime per komitetet ad-hoc te testimi, lidhur me pergjegjesite dhe detyrat e tyre, si edhe me zhvillimin e konkurimit. Ne te njejten kohe, parashikohen te hartohen manuale dhe procedura per menyren e hartimit te testeve dhe subjekteve. Ne kete aktivitet

Departamenti i Administrates Publike po mbeshtetet edhe nga nje projekt i financuar nga programi CARDS 2003.

3. Sigurimi i qendrushmerise institucionale dhe financiare afatgjate per Institutin e Trajnimit te Administrates Publike Deri me sot, Instituti i Trajnimit te Administrates Publike i ka zhvilluar trajnimet e tij ne salla te marra me qera, duke rritur ne kete menyre koston e zhvillimit te procesit te trajnimit. Eshte siguruar nje godine te veçante per ITAP, e cila eshte e pershtatshme per t'u transformuar ne ambiente trajnimi dhe per zyrat e institutit. Kjo godine ka nevojte te ristrukturohet dhe te pajiset me orendite e nevojshme per zhvillimin e trajnimit. Per kete qellim eshte parashikuar nje fond i veçante ne kuadrin e programit CARDS 2004, projekt i cili do te filloje te zbatohet sapo programi te behet efektiv. Parashikohet qe perfundimi i rikonstruksionit dhe paisja e ambienteve me salla te perfundoje brenda 3-mujorit te katert te vitit 2005.
4. Duke filluar nga viti 2004, qeveria ka filluar financimin me 100% te aktivitetit te ITAP, duke spostuar financimet nga donatore te huaj vetem per projekte te veçanta. Nje menyre e tille financimi nga buxheti i shtetit do te vazhdoje edhe per periudhen ne vazhdim, duke krijuar siguri ne vazhdimesine e procesit te trajnimit te nepunesve civile.
5. Rritja e kapaciteteve te ITAP dhe ministrive te linjes lidhur me vleresimin e nevojave per trajnim. ITAP ka zhvilluar gjate dy viteve te fundit nje aktivitet te larmishem, per sa i perket temave te trajnimit te ofruara. Me zhvillimin e nje sere temash trajnimi dhe rritjen e kerkesave te institucioneve te administrates per trajnime, tanime jo te pergjithshme, por te posaçme, del i nevojshem perpunimi i nje metodologjie per vleresimin e nevojave per trajnim, e cila te percaktojte procedurat qe duhen ndjekur, si edhe rolin dhe detyrat qe institucione te veçanta do te kene ne kete proces. Hartimi i kesaj metodologjie do te shoqerohet edhe me trajnimin e personave te cilet do te jene pergjegjes per zhvillimin e procesit.
6. Ne kete aktivitet, Departamenti i Administrates Publike dhe ITAP do te asistohen nga nje projekt i veçante ne kuadrin e programit CARDS 2003. Metodologjia dhe trajnimi i personave pergjegjes parashikohen te perfundojne brenda 3-mujorit te fundit te vitit 2005.
7. Ofrimi i trajnimeve per nepunesit civile. ITAP e mbeshtet aktivitetin trajnues ne programe vjetore pune, te cilat miratohen nga Departamenti i Administrates Publike. Programi vjetor i trajnimit miratohet nga Departamenti i Administrates Publike ne fund te çdo viti kalendarik per vitin ne vijim dhe ne fund te vitit ITAP paraqet nje raport lidhur me realizimin e planit te trajnimeve. Ofrimi i trajnimeve eshte nje aktivitet i cili zhvillohet ne menyre te vazhdueshme dhe per kete arsye nuk ka ndonje afat te veçante per realizimin e tij. Nje mase e tille do te kryhet çdo vit. ITAP e monitoron aktivitetin trajnues edhe nepermjet indikatoreve te trajnimit, te cilet publikohen vazhdimisht ne faqen e internetit te Departamentit te Administrates Publike.
8. Ofrimi i trajnimeve ne fushen e Bashkimit Europian. Mbeshtetur ne nevojat qe paraqet administrata publike shqiptare ne procesin e negocimit per antaresimin ne Bashkimin Europian dhe ne nje faze te dyte, forcimin e njohurive te funksionimit te institucioneve komunitare pas antaresimit ne BE, ka filluar hartimi i nje strategjie te posaçme per trajnimin e nepunesve publike ne çeshtje te lidhura

ngushte me funksionimin e Bashkimit European. Kjo strategji parashikon bashkeveprimin e disa institucioneve kyç te perfshira ne proces (Ministria e Integritit European, Departamenti i Administrates Publike, Instituti i Trajnimit te Administrates Publike), te cilat do te percaktojne nevojat dhe fushat ku nevojitet trajnimi, percaktimin e target group te nepunesve publike, etj. Strategjia parashikohet qe te miratohet brenda tremujorit te dyte te vitit 2005.

Kjo strategji parashikon ofrimin e trajnimeve te ndare ne tre faza kohore:

- **Ne periudhe afatshkurter** – trajnim per njohuri te pergjithshme mbi funksionimin e BE per nepunesit e angazhuar ne procesin e stabilizim – asociimit;
- **Ne periudhe afatmesme** – rritja e kapaciteteve te nepunesve publike te perfshire ne procesin e negocimit dhe te antaresimit te Shqiperise ne BE, si dhe per ata te perfshire ne procesin e implementimit te *acquis communautaire*;
- **Ne periudhe afatgjate** – rritja e kapaciteteve te nepunesve publike per te siguruar qe Shqiperia merr pjese aktive si anetare e BE ne aktivitetin e perditshem te strukturave komunitare dhe kontribuon ne zhvillimin e metejshem te tyre.

1. Mbeshtetja e trajnimit ne pushtetin vendor. Ne vitin 2004 ITAP ka ofruar disa aktivitete trajnuese te posaçme per punonjesit e pushtetit vendor. Per te mbeshtetur aktivitetin e trajnimit ne organet e pushtetit vendor eshte krijuar edhe nje agjenci e posaçme trajnimi (Agjensia e Trajnimit te Pushtetit Vendor - ATPV). Meqenese ky institucion eshte i ri, ITAP do te bashkepunoje ngushte me te per te ofruar asistencen e tij ne fushen e hartimit te kurrikulave, identifikimin e nevojave per trajnim, dhenien e trajnimeve dhe pershtatjen e kurrikulave ekzistuese per punonjesit e pushtetit vendor.

2. Strategji te ndryshme te miratuara nga qeveria shqiptare, kane bere te nevojshme kryerjen e nje analize funksionale dhe strukturore te ministrive dhe te institucioneve ne varesi te tyre. Kjo analize eshte perqendruar ne identifikimin e: misioneve te institucioneve; funksioneve qe mbivendosen; funksioneve dhe; sherbimeve qe mund te kryhen nga tregu privat i ofrimit te sherbimeve; funksioneve te rezultuara te teperta; funksioneve te reja qe duhet te kryejne keto institucione.

Ne fazen e pare te permiresimit te strukturave te administrates publike eshte kryer nje nderhyrje ne qendren e ekzekutivit duke lehtesuar Keshillin e Ministrave nga 6 institucione varesie, te cilat kane kaluar ne varesi te ministrive te linjes. Gjithashtu jane kryer edhe disa ndryshime ne organizimin e ketyre institucioneve per te bere strukturave e tyre me eficente te shoqeruara ne disa raste me konvertimin e misionit te punes dhe shkurtime te numrit te punonjesve. Kjo praktike eshte menduar te shtrihet ne te gjitha institucionet e sferes se ekzekutivit, per te verifikuar efektshmerine e tyre, organizimin struktural (evidentimin e strukturave te teperta, rishikimin e strukturave dhe reduktimin e tyre, ose shtimin e njesive te reja) dhe funksionet qe ato kryejne. Veprimit konkret do ti paraprijë nje analize e ketyre institucioneve, e cila do te kryhet nga Departamenti i Administrates Publike me asistencen e nje projekti te financuar nga Banka Boterore, i cili ka filluar te implementohet ne fillim te vitit 2005.

Brenda tre mujorit te pare te vitit 2006 parashikohet te perfundoje analiza funksionale dhe strukturore e ministrive te linjes dhe institucioneve ne varesi te tyre, si edhe pergatitja e rekomandimeve dhe planit te implementimit te tyre.

3. Me qellim permiresimin funksional te institucioneve te administrates publike, parashikohet te rishikohet procesi i hartimit te pershkrimin te punes dhe i vleresimit te pozicioneve te punes. Keto dy procese jane shume te rendesishme ne percaktimin e detyrave per secilin pozicion pune ne kuadrin e institucionit, si edhe per kategorizimin e pozicioneve te punes per efekt page. Ne kete kuader eshte parashikuar te hartohen udhezime per pershkrimin e punes, pershkrime pune tip per pozicione te njejta ne te gjitha institucionet si edhe pjesa e pershkrimeve te punes per funksionet e perbashketa. Ky proces, i cili do te kryhet me asistencë te financuar nga projekti CARDS 2003, parashikohet te perfundoje brenda tre mujorit te pare te vitit 2006.
4. Pas perfundimit te procesit te permendur ne piken me siper, DAP do te kontrolloje zbatimin e standarteve lidhur me pershkrimin e punes dhe hartimin e tyre ne perputhje me udhezimin ne te gjitha institucionet e sferes se ekzekutivit. Ky proces do te shtrihet ne kohe dhe do te jete i lidhur ngushte me rishikimin funksionalo – strukturor te ketyre institucioneve. Parashikohet te filloje ne tremujorin e dyte te vitit 2006 dhe te shtrihet deri ne fund te vitit 2007.
5. DAP ka hartuar nje studim gjithepershires te sistemit te pagave ne Shqiperi, duke evidentuar te gjitha sistemet e pagave, me avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Mbeshtetur ne kete studim, eshte krijuar nje grup pune ne nivel nderministror per te studiuar zgjidhje te mundshme dhe per te marre vendime ne terma afatgjate. Ky grup pune do te hartojte nje dokument politikash (policy paper), e cila do te miratohet nga Bordi Nderministror per Reformen Institucionale dhe Administraten Publike ne maj 2005 dhe ne te cile do te percaktohen te gjitha masat qe do te merren ne nivel legjislativ dhe me tej, si edhe modalitetet e nderhyrjes ne sisteme te veçanta. Qellimi kryesor eshte te krijohet nje sistem i qarte dhe i mireartikular, ku çdo institucion te gjeje veten e tij ne nje hierarki te te gjitha institucioneve te administrates publike. Mbeshtetur ne kete politike te miratuar nga qeveria, eshte parashikuar qe brenda tre mujorit te dyte te vitit 2006 te kryhet dhe te perfundoje nderhyrja ne sistemin e pagave per institucionet ne varesi te Keshillit te Ministrave dhe institucionet e pavarura.
6. Me hyrjen ne fuqi te ligjit “Statusi i nepunesit civil” dhe te akteve nenligjore ne zbatim te tij, eshte krijuar nje sistem shperblimi per nepunesit civile, i cili mund te shkoje deri ne tre paga mujore, ne varesi te vleresimit vjetor te punes. Sistemi i vleresimit te punes, megjithese ka filluar te jete nje pjese e praktikes administrative te punes ne institucionet e administrates qendrore, ka paraqitur disa probleme te cilat lidhen me efikasitetin e vleresimit te punes dhe kryerjen e nje lidhjeje logjike mes vleresimit te nepunesve dhe realizimit te objektivave nga institucioni. Ne te njejten kohe ka pasur disa sugjerime per rishikimin e formularit te vleresimit dhe thjeshtezimin e tij.

Per kete arsye, pas kryerjes edhe te ndryshimeve ne ligj, eshte parashikuar te rishikohet procesi i vleresimit te punes dhe te permiresohen dispozitat lidhur me shperblimin e nepunesve civile mbeshtetur ne vleresimin e punes, si edhe menytrat e parashikimit te fondeve buxhetore per shperblimin e nepunesve. Ky aktivitet parashikohet te kryhet edhe me asistencen e nje projekti te financuar ne kuadrin e programit CARDS 2003 dhe parashikohet te perfundoje brenda vitit 2005.

7. Ngritja e nje rrjeti qeveritar per transferimin e te dhenave. Ky projekt eshte i nje rendesie te vecante dhe parashikon lidhjen ne nje rrjet te ministrive te linjes, me qellim transferimin e te dhenave dhe te informacionit, ne nje faze te pare dhe ne nje faze te dyte, edhe komunikimet zanore. Fillimisht do te ngrihet infrastruktura e nevojshme mbi te cilen do te zhvillohen sherbime te ndryshme, si portale te ndryshme qeveritare, vendosja e sherbimit te e-mail dhe ne te ardhmen aplikimi i nje sistemi te menaxhimit te dokumentacionit me baze edhe mesazhet e-mail, perfshirjen dhe integrimin e data base te ndryshem me aplikacion sektorial ose te pergjithshem, etj. Qeveria Italiane do te asistoj qeverine ne transmetimin e best practices ne kete fushe dhe ne identifikimin e sherbimeve qe do te ngrihen.

Aktualisht eshte kryer tenderi per prokurimin e paisjeve te nevojshme per ngritjen e infrastruktures dhe parashikohet qe pilotimi i funksionimit te sistemit te kryhet brenda tre mujorit te trete te vitit 2005.

Qeveria Shqiptare asistohet financiarisht dhe ne asistencen teknike ne kete projekt nga Bashkimi European ne kuadrin e programit CARDS dhe nga UNDP.

8. Me asistencen e BE ka filluar te zbatohet nje projekt per krijimin dhe venien ne funksionim te nje Regjistri Kombetar te Nepunesve te Administrates Publike (data base i administrates publike), i cili do te perfshije te dhena per te gjitha punonjesit e renditur te listen e pagave te qeverise, strukturat organizative te institucioneve te administrates publike, te dhena mbi pagat dhe kontributet e nepunesve, etj.

Nje projekt i tille paraqet rendesi si ne hartimin e politikave te fokusuar per burimet njerezore te administrates publike, per menaxhimin e ketyre burimeve, por edhe ne llogaritjen e shpenzimeve buxhetore per pagat dhe shperblimet, shpenzime te cilat zene nje pjese te konsiderueshme te buxhetit te shtetit (eshte parashikuar nje lidhje me sistemin e thesarit te shtetit).

Infrastruktura per kete data base eshte ngritur dhe Departamenti i Administrates Publike e permireson ne menyre te vazhdueshme ate, mbeshtetur ne eksperiencen e perfituar nga menaxhimi ne praktike i ligjit. Nga ana teknike eshte arritur ne perfundimin se aplikimi, i cili fillimisht eshte ndertuar mbi nje platforme Oracle, per lehtesi menaxhimi, hedhje informacioni, kontroll dhe gjenerim raportesh te ndryshme, duhet te konvertohet ne nje aplikacion web based. Departamenti i Administrates Publike eshte duke punuar ne kete drejtim dhe parashikohet qe te pilotohet funksionimi i programit te perfunduar ne kete platforme brenda tre mujorit te dyte te vitit 2005.

9. Venia ne funksionim dhe mirembajtja ne vazhdim e ketij sistemi sjell si domosdoshmeri rritjen e numrit te stafit te angazhuar ne fushen e zhvillimit te teknologjive te informacionit edhe me dy specialiste te tjere.

Pas pilotimit të funksionimit është parashikuar që të fillojë popullimi me të dhëna në sistemin, procesi i cili do të kryhet nga vetë institucionet e administratës publike nën mbikqyrjen dhe drejtimin e Departamentit të Administratës Publike. Përpara fillimit të këtij procesi është parashikuar një trajnim i posaçëm për personat që do të ngarkohen me menaxhimin e të dhënave, si përsa i përket hedhjes së të dhënave, ashtu edhe për përdorimin e sistemit për gjenerimin e raporteve. Parashikohet që sistemi të jetë plotësuar me të dhëna në pjesën më të madhe të tij brenda tremujorit të tretë të vitit 2006 dhe të fillojë të funksionojë normalisht.

10. Përmirësimi i vazhdueshëm i web-site-it të Departamentit të Administratës Publike. Në periudhën e fundit faqja e internetit e DAP është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe është rritur shumë vëllimi i informacionit të përfshirë në këto faqe, duke filluar nga strategjitë e ndryshme të qeverisë në fushën e administratës publike, mënyrën e organizimit të institucioneve të administratës qendrore, e deri në aktet e ndryshme ligjore me rëndësi në fushën e administrimit institucional. Gjithashtu është tentuar që kjo faqe interneti të kthehet në një forum diskutimesh për administratën publike duke vënë në dispozicion hapësira në të.

Megjithatë pjesa më e rëndësishme e kësaj faqeje lidhet me procesin e pranimit në administratën publike. Është bërë e mundur që të këtu një përditesim në kohë reale të gjendjes së procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe është ndryshuar struktura e kësaj rubrike. Kështu pas publikimit të shpalljes së vendit të lirë, janë parashikuar rubrika të veçanta me listën e personave të paraselektuar, datën dhe vendin e zhvillimit të konkurimit dhe më pas, renditjen e kandidatëve për konkurimit dhe shpalljen e kandidatit fitues.

Kjo punë do të vazhdojë me zhvillimin e procesit të menaxhimit të këtij informacioni duke e shndërruar në fazën finale në një *content management system* i faqes së internetit, ku sipas proceseve të punës, secili nëpunës i Departamentit do të nderhyjë vetë në faqen e internetit, duke qenë përgjegjës për përmbajtjen dhe përditesimin e informacionit. Gjithashtu është parashikuar edhe krijimi i një sistemi të posaçëm për menaxhimin e dokumentacionit në formë elektronike, projekt i cili do të aplikohet fillimisht në Departamentin e Administratës Publike, me synimin për të shtrirë në të ardhmen në institucionet e tjera të administratës publike. Këto aktivitete parashikohet të kryhen brenda tre muajve të parë të vitit 2006.

11. Rritja e standardeve etike në funksionimin e administratës publike ka qenë në qendër të vëmendjes së qeverisë. Për këto arsye janë miratuar ligji “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe VKM “Për veprimtaritë e jashtme dhe dënimin e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”. Me qëllim njohjen e nëpunësve me dispozitat e këtyre akteve dhe për t’i njohur me standardet me të mira të aplikuar në këto fushë, është parashikuar që të zhvillohen trajnime të posaçme lidhur me etikën dhe antikorrupsionin. ITAP ka parashikuar të zhvillojë një trajnim të tillë 10 herë gjatë vitit 2005. Ky trajnim do të shoqërohet edhe me masa të tjera lidhur me informimin e nëpunësve për dispozitat ligjore në fuqi dhe për detyrimet që ata kanë sipas standardeve të etikës.

Ndihma e huaj

Ne pergjithesi te gjitha masat e parashikuara (legjislative dhe zbatuese) do te financohen nga buxheti i shtetit. Megjithate, per aktivitete te veçanta Departamenti i Administrates Publike eshte asistuar dhe do te asistohet nga projekte te financuara nga BE, Banka Boterore dhe UNDP.

Lidhur me shtesat ne organike, ne pergjithesi jane parashikuar 7 nepunes shtese ne Departamentin e Administrates Publike. Llogaritet qe nje nepunes civil ne nivelin e specialistit te larte ti kushtoje buxhetit te shtetit 663.828 leke ne vit (ne kete shume eshte llogaritur sikur ky nepunes ka vjetersi maksimale). Per punonjesit e sektorit te IT duhet te shtohet mbi kete shume edhe shtesa per kushte te veçanta ne vleren 180.000 leke ne vit.

Tabela e masave legislative

Masa kombetare	Masa e BE	Niveli i pajtuesmerise me A. Communautaire	Autoriteti	Statusi i perkthimit	Ndihma e kërkuar/siguruar teknike	Dt. e paraqitjes ne KN ose ne Kuveret
Ndryshimi i ligjit nr. 8549 date 11.11.1999 "Statusi i nepunesit civil"	Jo i aplikueshem	Jo i aplikueshem	DAP	Jo i aplikueshem		
Hartimi i akteve te reja ose ndryshimi i atyre ekzistuese ne zbatim te ligjit "Statusi i nepunesit civil"	Jo i aplikueshem	Jo i aplikueshem	DAP	Jo i aplikueshem	Siguruar: Ne percaktimin e metodologjive dhe procedurave asistohemi nga CARDS 2003 (1 milion Euro), komponenti asistence teknike me vlere 750 000 euro P.S: (kjo shume perfshin asistence ne disa komponente, te cilat do te trajtohen edhe ne masa te tjera me poshte)	
Hartimi i	Jo i	Jo i aplikueshem	DAP	Jo i		

akteve nenligjore per hedhjen e te dhenave, perditesimin dhe perdorimin e tyre ne data-base te nepunesve te administrates publike	aplikueshem			aplikueshem		
---	-------------	--	--	-------------	--	--

Tabela e masave zbatuese

Autoriteti	Detyrat	Ndihma e kerkuar teknike	Fillimi	Fundi
DAP	Pershtatja e struktures ekzistuese me dispozitat e ligjit "Statusi i nepunesit civil", i ndryshuar: - shtimi me 3 specialiste i sektorit te ngarkuar me mbikqyrjen e procesit te rekrutimeve - shtimi me 2 specialiste i sektorit te ngarkuar me vleresimin e pozicioneve te punes dhe reformen funksional strukturore			Mbas ndryshimit te ligjit – korrik 2005
DAP	Hartimi i udhezimeve per veprimtarine e komiteteve ad-hoc te testimit. Hartimi i manualeve per menyren e hartimit te testeve dhe subjekteve	Siguruar: CARDS 2003 (1 milion Euro) asistence teknike me vlere 750 000 euro		Nentor 2005
DAP, ITAP DAP, KM	1. Rikonstruksioni i ambienteve te reja te ITAP 2. Financimi i aktivitetit	Siguruar: CARDS 2004 (2 milion Euro) asistence teknike me vlere 350.000 euro		Dhjetor 2005 Çdo vit ne vazhdim, me

	te ITAP nga buxheti i shtetit			miratimin e ligjit te buxhetit
DAP, ITAP	Rritja e kapaciteteve te ITAP dhe ministrive te linjes lidhur me vleresmin e nevojave per trajnim	Siguruar: ITAP do te asistohet nga CARDS 2003 (1 milion Euro), asistence teknike me vlere 750 000 euro		Tetor 2005
ITAP	Ofrimi i trajnimeve per nepunesit civile		Janar 2005	Dhjetor 2006
ITAP	1. Ofrimi i trajnimeve ne fushen e Bashkimit Europian 2. Hartimi i nje strategjie te posaçme per trajnimin e nepunesve publike ne çeshtje te lidhura ngushte me funksionimin e Bashkimit Europian		Tremujori i II 2005	Ne vazhdim Tremujori i II 2005
ITAP, ATPV	Mbeshtetja e trajnimit ne pushtetin vendor			Gjate vitit 2005
KM, DAP, ministrive e linjes	1. Hartimi i misioneve dhe funksioneve te rishikuara te ministrive dhe sistemit te tyre 2. Perfundimi i analizes funksionale – strukture te ministrive te linjes dhe institucioneve ne varesi te tyre dhe pergatitja e rekomandimeve dhe planit te implementimit te tyre	Qeveria asistohet ne kete fushe nga nje projekt i financuar nga Banka Boterore me vlere rreth 700 000 \$		Tetor 2005 Tremujori i I 2006
DAP	Permiresimi i procesit te hartimit te pershkrimit te punes dhe vleresimit te pozicioneve te punes. Hartimi i pershkrimeve	Siguruar: DAP asistohet ne kete fushe nga CARDS 2003 (1 milion Euro),		Tremujori i I 2006

	te punes tip per pozicione te njejta dhe pjeset e pershkrimeve te punes per funksione te perbashketa	asistence teknike me vlere 750 000 euro.		
DAP, institucionet e varesise	Hartimi i pershkrimeve te punes ne te gjitha institucionet e ekzekutivit sipas standarteve dhe udhezimeve te miratuara	Siguruar: CARDS 2003 (1 milion Euro), asistence teknike me vlere 750 000 euro Program i BB per rishikimin organizativo - funksional	Tremujori i II 2006	Tremujori i IV 2007
DAP, Bordi Nderministror per Reformen Institucionale dhe Administraten Publike	1. Miratimi i "policy paper" per permiresimin e sistemit te pagave dhe shperblimeve ne administraten publike dhe i planit te masave per kete qellim 2. Realizimi i nderhyrjes ne sistemin e pagave per institucionet ne varesi te KM dhe institucionet e pavarura			Maj 2005 Tremujori i II 2006
DAP	Permiresimi i sistemit vjetor te vleresimit te punes lidhur edhe me shperblimet ne fund te vitit	Siguruar: CARDS 2003 (1 milion Euro) asistence teknike me vlere 750 000 euro.		Dhjetor 2005
KM, DAP	Ngritja e rrjetit qeveritar per transmetimin e te dhenave – pilotimi i funksionimit	Siguruar: CARDS 2003 (1 milion Euro) asistence teknike me vlere 750 000 euro dhe UNDP. Qeveria Italiane do te asistojte ne zhvillimin e aplikacioneve		Tremujori i III 2005

		mbi kete sistem		
DAP	Konvertimi i data base te nepunesve civile ne nje aplikacion web based – pilotimi i funksionimit Plotesimi me te dhena i sistemit dhe venia plotesisht ne funksionim			Qershor 2005 Tremujori i III 2006
DAP	Rritjen e numrit te stafit te Sektori te informatizimit te administrates dhe koordinimit te projekteve me 2 specialiste te tjere			Tremujori i II 2005
DAP	Permirosimi i vazhdueshem i faqes se internetit te DAP dhe zhvillimi i aplikacioneve te menaxhimit te dokumentacionit			Tremujori i I 2006
ITAP	Zhvillimi i trajnimeve te nepunesve civile ne fushen e etikes		Shkurt 2005	Dhjetor 2005

Perparesite afatmesme 2008-2009

Nuk jane parashikuar masa legjislative ne kete periudhe

Masa zbatuese

1. Ne vazhdim te nderhyrjeve ne sistemin e pagave te parashikuara per tu kryer deri ne fund te periudhes afatshkurter, ne fazen e dyte afatmesme, do te vazhdoje nderhyrja ne sistemin e pagave per institucionet ne varesi te ministrive. Kjo nderhyrje do te shtrihet gjate vitit 2007, ne varesi edhe te afateve dhe planit te veprimeve qe do te miratohet ne dokumentin e politikave (*policy paper*), nga Bordi Nderministror per Reformen Institucionale dhe Administraten Publike.
2. Ne vazhdim te aktiviteteve te parashikuara ne kete fushe ne periudhen afatshkurter dhe pas perfundimit te analizes funksional – strukurore te institucioneve te sferes se ekzekutivit, do te filloje nderhyrja per rritjen e efijences se strukturave te institucioneve ne varesi te ministrive te linjes. Ky aktivitet do te kryhet me disa faza

duke u shtrire gradualisht nga nje sistem ministror ne nje tjetër, ne perputhje me planin e veprimeve qe do te miratohet per kete qellim. Ne kryerjen e ketij aktiviteti Departamenti i Administrates Publike do te mbeshetet nga nje projekt i financuar nga Banka Boterore ne vlere rreth 700 000 \$. Parashikohet qe brenda vitit 2007 te perfundoje rishikimi i strukturave te institucioneve te varesise, duke eleminuar institucionet e rezultuara te teperta, njesite organizative qe dublojne njera-tjetren, etj.

3. Mbeshtetur ne analizen e nevojave per trajnim ITAP do te ofroje trajnime per nepunesit civile, sipas programit vjetor te trajnimeve. Trajnimet do te mbesheten ne strategjine afatmesme te ITAP dhe do te shtrihen ne pese fushat kryesore te trajnimit te miratuara. Gjithashtu, mbeshetur edhe ne strategjine e trajnimit per çeshtjet e BE do te hartohen dhe levrohen trajnime te specializuara per rritjen e aftesise se nepunesve publike per te negociuar antaresimin ne BE dhe per zbatimin e *acquis communautaire*. Keto trajnime do te levrohen gjate gjithë vitit ne te gjithë periudhen 2007-2008.
4. Mbi infrastrukturen e ngritur te rrjetit qeveritar te transmetimit te informacionit, do te filloje vendosja e aplikacioneve te ndryshme, te cilat do te identifikohen ne periudhen afatshkurter. Kryesisht synohet vendosja e aplikacioneve per ofrimin e sherbimeve *on line*, dhenien e licencave, etj. Eshte parashikuar qe keto aktivitete te mbesheten nga BE ne kuadrin e programit CARDS. Aktualisht eshte bere nje propozim per programin CARDS 2005-2006, i cili eshte miratuar ne parim. Me detajimin e termave te references dhe duke pasur parasysh ecurine e metejshme te GovNet, do te percaktohen edhe produktet konkrete qe do te levrohen ne kete fushe. Parashikohet qe fillimi i aplikimeve te rendesishme te filloje ne vitin 2007 dhe te shtrihet ne vazhdim.

Tabela e masave zbatuese

Autoriteti	Detyrat	Ndihma e kerkuar teknike	Fillimi	Fundi
DAP	Implementimi i planit te masave per permiresimin e sistemit te pagave ne institucionet e varesise			Tremujori i IV 2007
DAP, ministrite e linjes	Rishikimi i strukturave te institucioneve te varesise, ne perputhje me misionet dhe funksionet e reja	DAP asistohet ne kete fushe nga nje projekt i financuar nga Banka Boterore me vlere rreth 700 000 \$		Tremujori i IV 2007
ITAP	Ofrimi i trajnimeve per nepunesit civile		2007	2008
KM, DAP	Zgjerimi i aplikacioneve ne rrjetin qeveritar te transmetimit te	Eshte kerkuar asistence teknike ne kuadrin e	2007	Ne vazhdim edhe ne

	informacionit	programeve CARDS 2005 – 2006, asistence e cila eshte miratuar ne parim nga BE		periudhen afatgjate
--	---------------	---	--	------------------------

Perparesite afatgjata 2009-2014

Me qellim forcimin e rolit te Institutit te Trajnimit te Administrates Publike, ITAP ka miratuar gjate vitit 2004 nje dokument strategjik te titulluar “Vizioni ITAP 2015”. Mbeshtetur ne praktikat me te mira ne kete fushe, eshte shprehur objektivi per nje permiresim cilesor te aktivitetit te ITAP dhe plotesimit sa me me cilesi te nevojave te “klienteve” te tij, per te qene nje institucion konkurues ne tregun e ofrimit te sherbimeve te trajnimit. ITAP synohet te kthehet ne nje qender kombetare per zhvillimin e praktikave me te mira ne menaxhimin e administrates publike, ne nje promovues te vlerave thelbesore te sherbimit civil, si edhe ne nje forum per diskutimin e çeshtjeve te ndryshme per sherbimin civil dhe administraten publike.
